

# **RAPORTI TEKNIK**

**(DIGA GJOKAJ 1)**

# 1. HYRJE

Te dhena te pergjitheshme:

Rezervuari I Gjokaj 1 eshte nje objekt i ndertuar per qellime ujitje ne vitin 1973 ne fshatin Vore, Bashkia Vore.

Objekti perbehet nga Diga prej dheu se bashku me te gjithë elementet e saj si dhe nga baseni ujqor.

Diga eshte ndertuar prej materiali vendore dhe me berthame argjile dhe ka keto dimensione.

## **GJENDJA AKTUALE E REZERVUARIT:**

Aktualisht rezervuari I Gjokaj ka probleme te rreshqitjes ne bjefin e poshtem te diges.

Rreshqitja konsiderohet e konsiderueshme ne pjesen fundore te diges.

Kjo rreshqitje ka krijuar shqetesim tek banoret qe ndodhen perrreth diges ne bjefin e poshtem pasi e konsiderojne si nje rrezik dhe per jeten e tyre .

Gjithashtu eshte demtuar dhe nje pjese e kanalit vadites qe kalon ne trupin e diges.

Por shqetesimi vjen dhe nga te gjithë banoret e fshatrave qe perfitojne uje nga ky rezervuar.

Fotografi të Gjendjes ekzistuese te Rezervuarit te Gjokaj 1 :



Ne te njejten kohe kolapsi dhe avancimi I rreshqitjes do te vazhdoje edhe nga gerryerjet qe shkakton shkarkuesi i diges i cili ka krijuar nje grope te madhe gjate shkarkimeve te nje-pasneshme duke rrezikuar keshtu demtimin e trupit te diges ne pjesen e poshtme te saj.

Duke konsideruar kete rrezik, Bashkia Vore po merr masa duke projektuar masat mbrojtese dhe determinante per te ruajtur kete dige dhe per te rritur jetegjatesine e saj.

## 2. DETYRA E PROJEKTIMIT

Bazuar ne Detyren e Projektimit, grupi eksperteve pasi beri rikonicion dhe vizita ne objekt , para dhe pas pastrimit dhe skarifikimit te bjefit te poshtem te diges, konstatoi :

### 2.1 Shkaqet e mundshme per favorizimin e shembjes

---

Disa nga shkaqet qe kane favorizuar kete rreshqitje po Ipershkruajm si vijon:

- Mungesa e gjate e mirembajtjes sipas rregullores se ketij rezervuari.
- Taposja dhe mosfunksionimi I drenazheve te diges.
- Favorizimi , Rritja dhe zhvillimi I pa kontrolluar I pemeve dhe shkurreve ne bjefin e poshtem te diges ne dhe perreth zones se rreshqitjes duke krijuar problem me rrenjezimin.
- Vendosja e tubacioneve te shumta mbi dige per marrjen e ujit, nga banore te shumte, per perdorim bujqesor, por jashte cdo kushti teknik, duke shkaktuar deme te medha mbi trupin e diges. ( pikerisht mbi zonen e rreshqitjes ).
- Gerryerja nga reshjet e shumta dhe nga mungesa e sistemeve te kullimit te ujrave te shiut ne siperfaqen e diges, ka bere qe nje pjese e madhe e dherave te diges te rreshqasin dhe te bien mbi kanalim e shkarkimit, dhe bllokimin e tij, duke bere qe diga te rrezikoje gerryerjen masive.
- Gerryerja nga mungesa e kanalit te shkarkimit katastrofik i cili eshte bllokuar nga nje biznes privat.

## 2.2 Rreziku i avancimit te shembjes

---

Lenja e diges ne kete gjendje do te perbente rrezik per vazhdimin e shembjes ne periudhen e plotave dhe pas mbushjes serezervuarit.

Ulja e rrezikut mund te ndodhe nese lihet rezervuari bosh pra pa uje.

Por kjo do te thote ti lesh pa uje dhe prodhim bujqesor rreth 50 Ha toke dhe mbi 32 familje qe marrin uje per mbijetes nga kyrezervuar.

## 2.3 Riparimi i diges

---

Grupi I projektimit ka percaktuar masat dhe nderhyrjet emergjente per riparimin e diges.

Gjithashtu konsideron disa nderhyrje qe permiresojne ndjeshemoperimin dhe funksionimin e Rezervuarit.

Te gjitha punimet qe do behen per riparimin e diges do jene subjekt i disa nderhyrjeve qe do behen me shume kujdes sepse cdo proces pune mbi trupin e diges e rrezikon me teper ate.

Prandaj punimet qe do kryhen do ndjekin nje rend te caktuar dhete mbeshtetura mbi projektin e dhene duke ndjekur specifikimet teknike ne kryerjen sa me efektive te ketyre punimeve.

Keto nderhyrje nxisin dhe rritjen e atraksionit turistik mbi kete vepre hidroteknike, duke e kthyer zonen ne nje pike reference per turizmin e kesaj zone.

Ky investim nxit dhe bizneset lokale per te zhvilluar turizmin liqenor mbi kete liqen.

### 3. PROJEKTIMI I NDERHYRJEVE


#### 3.1 Riparimi i bjefit te siperm dhe te poshtem te diges

Skarifikim ,pastrim shkurre dhe bimesi ne bjefin e siperm dhe teposhtem.

Gjithashtu rimodelimi I skarpates, si dhe veshje e skarpates nebjefin e siperm me cakull dhe gure per te parandaluar shplarjen e dherave te diges dhe sufozine.


Ndersa bjefi i poshtem trajtohet me gjelberim ( bare me sistemrrenjore te ulet).

Keto masa ndermeren bazuar ne kushtet Teknike te digave prej dheu.



Biefi i Siperm:



Biefi i Poshtem:



### 3.2 Ndertimi i mbrojtjes me mure gabion ne biefin e poshtem te diges

Ndertimi i murit gabion ne pjesen e poshtem te diges eshte nevojte imediate dhe emergjente per mbrojtjen dhe ruajtjejn e kesaj vepre hidroteknike per te qene funksionale edhe per te mos rrezikuar jeten e banoreve dhe sipërfaqeve te tokave ne pjesen e poshtme te saj.

Muret gabion do te jene si me poshte ne skicat perkatese



Shenim:


Koshat Gabion do te jene ne dimensionet 100x100x200, me material tel xingato.

Mbushja e koshave do te behet me gure mali, nga guret e zones me te afert.

### 3.3 Riparimi i kanalit te hapur te ujitjes, qe merr ujin e shkarkuesit ne pjesen e poshtme te diges ne trupin e diges.

Riparimi i kanalit te hapur te ujitjes ne trupin e diges rrit sigurine e diges, duke zvogeluar gerryerjet dhe filtrimet e ujit ne trup te diges. Duke e pastruar nga shkurret, duke prijuar profilimin e kanalit dhe ne vazhdim betonimin e tij per te zvogeluar kontaktin e ujit me dherat e trupit te diges..


Kjo mase do te beje te mundur eleminimin e ujerave ne kontakt me dherat e trupit te diges qe mund te sjellin rrezik per shembje te tjera ne te ardhmen.






## 1.1 Nderhyrjet ne Rruget e aksesueshme ne trupin e diges, Riparimi i kurores se diges

Duke qene se diga ka rruge aksesimi gjate trupit te diges eshte menduar sistemimi dhe shtresezimi, si dhe ndricimi i diges.



### Seksioni Tip i Rruges ne gjitje, te diges




## 1.2 Riparimi i kurores se diges

Kurora e diges ne gjendjen aktuale eshte e deformuar teresishtdhe e pa trajtuar.



Projekti parashikon konturimin e kurores se diges me seksion me gjeresi 5 m dhe ndertim bordure b/a me madhesi 20x35 cm ne dy anet e diges.

Kurora do te shtrohet me nje shtrese cakulli me trashesi 15 cm, dhe nje shtrese stabilizant me trashesi 10 cm dhe te rrulohet.




Njekohesisht do te kete nje sistem per largimin e ujrave te shiut ne menyre te kontrolluar ne pjesen e brendshme te rezervuarit.

Ky sistem I largimit te ujerave paraqitet sipas seksionit tip te meposhtem:



Ndririm i kurores se diges me 20 ndricues me shtylla metalike 6ml me ndricues led fotovoltaik.



Kurora e diges mund te jete e aksesueshme per mjete me tonazhte ulet dhe nje atraksion per banoret e vores dhe zonave perreth.

Ne brendesi te rezervuarit ne krahe te pusetes se marrjes se ujit do te instalohet dhe tabela qe do te tregoj nivelin e ujitne rezervuar dhe per llogaritjen e volumit te ujit.  
Zakonisht vendosen lata si ne figuren me poshte dhe shenohen kuotat ne late per te pare nivelin e ujit.



Ne total do jene 4 stacione topografike me ane te se cileve, here pas here do monitorohet diga per te pare nese ka levizje te kurores se diges apo jo.

Detaji 1 i Stacioneve te Monitorimit

